

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 107/2016, “PËR PREFEKTIN E QARKUT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektakti ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107 datë 27.10.2016 “Për prefektin e qarkut”’ synon përforcimin i rolit të prefektit të qarkut, misionit dhe kompetencave në përmbushje të detyrave të tij, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në qark.

Domosdoshmëria e ndryshimeve ligjore, për ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e qarkut” ka lindur si nevojë për të rritur efikasitetin dhe konsolidimin e performancës së prefektit të qarkut, për ofrimin e shërbimeve më cilësore, për një qeverisje gjithmonë e më pranë qytetareve, si dhe përforcimit të rolit të tij në qark.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj lidhet me realizimin e programit të Këshillit të Ministrave dhe është i parashikuar në Programin Analitik të Projektakteve për Ministrinë e Brendshme për vitin 2023.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektakti rregullon problemet e evidentuara nga zbatimi i ligjit të vjetër “Për Prefektin e Qarkut”, në lidhje me:

- Krijimin e grupeve të punës dhe task-forcave për të ndjekur politikat e nivelit kombëtar ose emergjencat rajonale;
- Problematikat në lidhje me përballimin e shpenzimeve për mbarëvajtjen e task-forcave;
- Nevojat për të përmirësuar verifikimin e funksioneve dhe përgjegjësi të deleguara nga qeverisja qendrore;
- Përdorimi i fondeve të parashikuara për këto funksione.

Ndër përparësitë e projektaktit, vlen të përmendet:

- Prefekti i qarkut verifikon dhe monitoron përmbushjen e standarteve kombëtare dhe kritereve të përcaktuara për zbatimin e normave kombëtare;
- Drejtuesit e Policisë së Shtetit në qark, informojnë prefektin e qarkut mbi shkallën e zbatimit të masave për ruajtjen e rendit, sipas përgjegjësi e detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore;
- Planet e veprimit, masat për tu marrë në qark në rast organizimesh sportive dhe kulturore hartohen në konsultim dhe dakordësi me strukturat e emergjencës së prefektit të qarkut;
- Përmirësimi i kuadrit rregullator mbi marrëdhëniet me institucionet qendrore që veprojnë në qark, bashkëpunimi me njëri-tjetrin për realizimin e përgjegjësi të përbashkëta, konsultimin dhe koordinimin e prioriteteve strategjike;
- Është shtuar struktura e kabinetit, si mbështetëse e drejtëpërdrejtë për realizimin e objektivave dhe vlerësimin e zbatimit të tyre, por që nuk do të jetë pjesë e strukturës hierarkike të prefekturës;
- Është parashikuar thirrja e ekspertëve të jashtëm në fushat për të cilat nevojitet ekspertiza, si dhe mbikëqyrja e këtij shërbimi nga nënprefekti, përmes fondeve të veçanta në buxhet;
- Është parashikuar zëvendësimi i prefektit nga nënprefekti, sipas Kodit të Procedurave Administrative;

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti propozohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, sipas të cilit ndër të tjera përcaktohet se, “*Këshilli i Ministrave merr vendime për përcaktimin e drejtimeve kryesore të politikës shtetërore*”, vendimin nr. 604, datë 20.10.2021 të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme*”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektakt nuk synon përafrimin me *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi i propozuar përmban ndryshimet dhe shtesat si vijojnë:

✓ Në nenin 1 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 4, pika 1 ndryshohet përkufizimi i akteve normative, me qëllim evidentimin e saktë që në pjesën hyrëse të ligjit të akteve që nxjerrin organet e njësisive të vetëqeverisjes vendore, si vijon:

“1. Akte me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, të cilat vendosin rregulla të përgjithshme sjelljeje, nuk shpëtojnë në zbatimin e tyre dhe që kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial të tyre.”.

Në nenin 2 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 6 (Kriteret e emërimit) bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fjalinë e parë fjala *‘shtetasi’* zëvendësohet me *‘kandidati’*.

2. Shkronjat ‘b’ dhe ‘ç’ ndryshojnë si vijojnë, me qëllim përcaktimin e degëve të arsimit të lartë në përputhje me përcaktimet e ligjit për arsimin e lartë në fuqi, në ndryshim nga ligji aktual i cili linte hapësirë mbi llojin e degëve të arsimit të lartë, si vijon:

‘b) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë ose të ketë diplomë të barazvlefshme me të ose të ketë përfunduar studimet e arsimit të lartë jashtë vendit dhe të ketë njohur dhe njësuar diplomën sipas përcaktimeve për njësimin e diplomave, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë, në shkenca shoqërore, juridike, ekonomike;

ç) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kundërvajtje penale’.

3. Në shkronjën ‘c’ pas fjalës ‘*të ketë*’ shtohet fjala ‘*të paktën*’, me synim vlerësimin e një kandidati me më shumë vite eksperiencë se dikush vetëm me 5 vite përvojë pune.

4. Pas shkronjës ‘ç’, shtohen shkronjat ‘d’ dhe ‘dh’ si vijojnë:

‘d) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar apo të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të mos jetë subjekt i ndalimeve sipas legjislacionit në fuqi për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Në nenin 3 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 8 (Përgjegjësitë kryesore të prefektit të qarkut), bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në shkronjën “a”, pas fjalës “*ligjshmërisë*” shtohet togfjalëshi “*së formës dhe përmbajtjes*” dhe kudo në ligj togfjalëshi ‘vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive’ zëvendësohet me fjalën ‘*akteve*’.

2. Në shkronjën ‘e’ dhe kudo në ligj hiqet togfjalëshi ‘*krijimin e organizmave të përkohshëm*’, pasi në praktikën e punës *de facto* ka rezultuar organizëm jo efektiv.

3. Në shkronjën ‘j’ në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi ‘*apo marrëveshje të veçanta*’, që mund të nënshkruajnë midis vetë prefektëve të qarqeve, apo me persona të tjerë të tretë.

4. Pas shkronjës ‘j’ shtohen përgjegjësitë e reja në shkronjat k), l) dhe m) si vijojnë:

‘k) monitoron zbatimin e projekteve, programeve sektoriale në qark, që zhvillohen me fonde të kushtëzuara apo fonde të qeverisë qendrore, veçanërisht për sa i përket respektimit të afatave dhe cilësisë’.

Procedura e monitorimit të zbatimit të politikave, projekteve e programeve sektoriale të qeverisë qendrore në nivel qarku përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

l) sinjalizon institucionet përgjegjëse inspektuese duke propozuar fillim të procedurës së inspektimit për shkeljet e evidentuara;

ll) jep certifikata nderi për persona me kontribut të veçantë në qark;

m) propozon pranë ministrit përgjegjës për çështjet vendore shkarkimin e kryetarit të bashkisë pjesë e qarkut përkatës në rast të kryerjes së shkeljeve të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve''.

✓ Në nenin 4 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 9 (Marrëdhëniet e prefektit të qarkut me Këshillin e Ministrave, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore), pas pikës 4, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Prefektët e qarqeve bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në realizimin e përgjegjësive të tyre dhe në identifikimin e interesave dhe problemeve të përbashkëta, përfshirë konsultimin dhe koordinimin e prioriteteve strategjike.”.

✓ Në nenin 5 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 10 (Marrëdhëniet e prefektit të qarkut me degët territoriale), bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:
“dh) kërkon nga dega territoriale dërgimin e planit vjetor të punës, si dhe një raport të hollësishëm me informacion për realizimin e tij, treguesit e performancës dhe problematikat e hasura çdo muaj.”.

2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

‘Ministri apo drejtuesi i institucioneve qendrore që veprojnë në qark komunikojnë drejtpërdrejtë me prefektin e qarkut për probleme të fushën e veprimtarisë së tyre, duke vënë në dijeni ministrin përgjegjës për veprimtarinë e prefektit të qarkut.’

3. Në pikën 2, para tofjalëshit ‘aktet e nxjerra’ shtohet tofjalëshi ‘zyrtarisht, të nesërmen pas miratimit të tyre’.

4. Pas pikës 2, shtohen pikat 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:

“3. Pas përfundimit të monitorimit të degëve territoriale që veprojnë në qark sipas përcaktimeve të kësaj dispozite, prefekti i qarkut informon ministrin përgjegjës dhe Kryeministrin.”.

Relacion shpjegues i projektligjit ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”

‘ 4. Në rast të ndryshimeve strukturore të degëve territoriale apo drejtorive të ministrive në qark, ndryshimi i bëhet me dije prefektit të qarkut.’

✓ Në nenin 6 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 11 (Propozimet për emërim dhe lirim të drejtuesve të degëve territoriale) shtohet pika 5, si vijon:

“5. Prezantimi i drejtuesit të ri kryhet në një ceremoni në të cilën merr pjesë prefekti i qarkut”.

✓ Në nenin 7 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 12 (Detyra në lidhje me organet e Policisë së Shtetit), pas pikës 4, shtohen pikat 5 dhe 6 me këtë përmbajtje:

“5. Drejtori i policisë vendore zhvillon takime të përbashkëta dhe informon çdo 10 ditë prefektin e qarkut mbi shkallën e zbatimit të masave për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike në nivel qarku, sipas përgjegjësive e detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore.”.

‘ 6. Planet e veprimit me masat përkatëse në rast organizimesh sportive, kulturore hartohen në konsultim dhe dakordësi me strukturat e emergjencë së prefektit të qarkut’.

✓ Në nenin 8 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 13 (Detyra në lidhje me strukturat e mbrojtjes) shtohen pikat 2 dhe 3 si më poshtë:

2. Prefekti i qarkut bashkërendon punën me strukturat e mbrojtjes dhe organet e vetëqeverisjes vendore në qark, për realizimin e detyrave në fushën e mbrojtjes civile.

3. Prefekti i Qarkut koordinon marrjen e masave nga njësitë e Forcave të Armatosura në lidhje me kapacitetet operationale të deklaruara në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile, që veprojnë në nivel qarku, me qëllim realizimin e detyrave me karakter civil që u ngarkohen sipas legjislacionit në fuqi.”.

✓ Në nenin 9 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 14 (Propozimi dhe drejtimi i task-forcave dhe organizmave të përkohshëm) bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në këtë nen hiqet togfjalëshi ‘*organizmave të përkohshëm*’.

2. Pas pikës 4, shtohen pikat 5 dhe 6 me këtë përmbajtje:

“5. *Funksionimi i task-forcave realizohet përmes fondeve dhe mjeteve të domosdoshme financiare*”.

‘6. *Masa dhe mënyra e kalimit të fondeve për funksionimin e task forcës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave*’.

✓ Në nenin 10 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 15 (Marrëdhëniet e prefektit të qarkut dhe organeve të vetëqeverisjes vendore) shtohet pika 4 si vijon:

‘‘4. *Prefekti i qarkut monitoron përmbushjen e standardeve kombëtare të përcaktuara në aktet rregullatore të cilat zbatohen në përmbushjen e misionit të prefektit të qarkut, duke:*

- a. *Grumbulluar informacion periodik në lidhje me nivelin e zbatimit të standardeve të shërbimeve publike sipas legjislacionit specifik;*
- b. *Sinjalizuar bashkitë dhe ministritë e linjës në lidhje me shmangiet e rëndësishme nga standardi kombëtar;*
- c. *Verifikuar përdorimin e fondeve publike apo transfertave të qeverisë qendrore kur ato janë dhënë për arritjen e standardit minimal kombëtar.*

Prefekti koordinon procesin e grumbullimit të të dhënave për Sistemin e Monitorimit të Performancës së Shërbimeve Publike të ofruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Raporti vjetor i performancës së shërbimeve publike të njësisë e vetëqeverisjes vendore është subjekt i verifikimit të të dhënave nga Prefekti.

✓ Në nenin 11 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 16 (Verifikimi i ligjshmërisë së akteve) pika 2, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fjalinë e pikës 2, pas fjalës “*ligjshmërisë*” shtohet togfjalëshi “*së formës dhe përmbajtjes*”.
2. Në shkronjën “a”, të pikës 2, pas fjalisë së parë, shtohet fjalia me përmbajtjen si vijon:

“Aktet me karakter normativ shoqërohen me një relacion përmbledhës të arsyeve për nxjerrjen e tyre, duke argumentuar mbi qëllimin, objektivat që synohen të arrihen, problematikat, përparësitë si dhe efektet e pritshme nga miratimi.”.

c) pas nënpikës “iv”, të shkronjës b) të pikës 2 shtohet nëndarja “v” me këtë përmbajtje:

“v) në rastet kur akti i depozituar te prefekti i qarkut nuk është me karakter normativ, prefekti i qarkut nuk shprehet për ligjshmërinë e tij, por e kthen atë.”.

✓ Në nenin 12 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 17 (Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve), bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalës “*ligjshmërinë e*” shtohet togfjalëshi “*formës dhe përmbajtjes së*”.
2. Në pikën 2 para togfjalëshit ‘*kërkon pavlefshmërinë e tyre*’ shtohet togfjalëshi ‘*njofton ministrin përgjegjës për çështjet vendore*’.
3. Në pikën 2, në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “*brenda 30 ditëve nga momenti i konstatimit.*”.

✓ Në nenin 13 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 18 (Verifikimi i përgjegjësive të deleguara), pika 1, shtohet fjalia me përmbajtjen si më poshtë:

“Për qëllime të ushtrimit të këtij funksioni, prefekti i qarkut kërkon informacion për performancën në ushtrimin e funksioneve e të përgjegjësive të deleguara nga pushteti qendror dhe për përdorimin e fondeve të transferuara për realizimin e tyre, nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore.”.

✓ Në nenin 14 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 19 (Shqyrtimi i ankesave dhe zgjidhja e konflikteve), pas fjalisë së fundit të pikës 3, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Me kërkesë të prefektit të qarkut, këto institucione i dërgojnë të dhëna statistikore për ankesat e paraqitura pranë tyre.”.

✓ Në nenin 15 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 20 (Vendimmarrja), pas pikës 1, shtohet pika 1/1 si vijon:

'1/1 Në zbatim të përgjegjësive të këtij ligji, prefekti i qarkut nxjerr urdhra për grupe pune të përbashkët të administratës së tij dhe inspektoriateve në qark, sipas rastit për verifikimin e shkeljeve të pretenduara në ankesat ndaj subjekteve publike apo private në qark'.

✓ Në nenin 16 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 21 (Administrata e prefektit të qarkut dhe burimet e financimit) bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 pas fjalës *'administratën'* shtohet fjala *'dhe kabinetin'*.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 si vijon:

'1/1. Struktura e kabinetit mbështet drejtpërdrejtë prefektin në ndjekjen e politikave, realizimin e objektivave dhe vlerësimin e zbatimit të tyre.

Kabineti nuk është pjesë e strukturës hierarkike të prefekturës.

Anëtarët e Kabinetit nuk ushtrojnë asnjë kompetencë drejtuese ose administrative mbi punonjësit e administratës së prefekturës'.

3. Pas pikës 1/1, shtohet pika 1/2 si vijon:

'Për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive, prefekti i qarkut thërret ekspertë të jashtëm të fushës përkatëse për të cilën nevojitet ekspertiza.

Nënprefekti mbikëqyr shërbimin e ofruar nga ekspertit për prefektin e qarkut, i cili realizohet përmes fondeve të veçanta në buxhet'.

4. Në pikën 2 para fjalës *'miratohen'* shtohet togfjalëshi *'dhe kabinetit'*.

5. Në pikën 4, në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi *'ndërsa të anëtarëve të kabinetit rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës'*.

✓ Në nenin 17 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 22 (Nënprefekti) bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 si vijon:

“1/1. Nënprefekti zëvendëson prefektin, sipas Kodit të Procedurave Administrative”.

2. *Hiqet pika 4.*

✓ Në nenin 18 të projektligjit parashikohet se:

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e vendimeve në zbatim të shkronjës “k”, të nenit 8 të ligjit, pika 6 e nenit 14 të ligjit brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

✓ Në nenin 19 të projektligjit parashikohet hyrja në fuqi, si vijon:

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen me zbatimin e projektligjit njësitë e qeverisjes vendore, prefektët e qarqeve.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të Ministrit të Brendshëm, nr. 58, datë 28.04.2023 “Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”.

Fillimisht projektvendimi dhe relacioni shoqërues është dërguar për mendim nëpërmjet sistemit e-aktet pranë:

- Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë,
- Ministrisë së Arsimit dhe Sportit,
- Ministrisë së Drejtësisë,
- Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky projektvendim është dërguar për mendim nëpërmjet e-mailit të datës 12.09.2023, pranë Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, por edhe për përfshirjen në mbledhjen e radhës së Këshillit Konsultativ, duke qënë në rolin e Sekretariatit Teknik të këtij këshilli:

Relacion shpjegues i projektligjit ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”

Gjithashtu projektvendimi është dërguar për mendim nëpërmjet e-mailit të datës 15.09.2023, pranë:

- Shoqatës për Autonomi Vendore;
- Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektakt nuk parashikohet të ketë efekte financiare në buxhetin e shtetit.

PROPOZUESI

MINISTRI

TAULANT BALLA